

PJESËMARRJA

AKP-ja organizon çdo muaj shitje të aseteve të ndërmarrjeve në likuidim. Publiku njoftohet përmes mjeteve informuese si mediave elektronike, shtypit botues, si mbrenda ashtu edhe jashtë Kosovës përmes WEB faqes zyrtare të AKP-së. Procesi i tenderimit realizohet me shkallën më të lartë të transparencës, të hapur për media duke u transmetuar drejtpërdrejt nëpërmjet faqes sonë të internetit.

SITË BËHEM OFERTUES POTENCIAL?

Parakualifikimi është një kriter që përfshinë një proces të thjeshtë. Për të mësuar më shumë rreth procedurave të parakualifikimit, ju duhet të:

- o Vizitoni apo kontaktoni AKP-në, zyrtarët e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë në:
tel: + 381 (0) 38 500 400 lok. 1105, 1090, 2004 & 2055,
ose përmes e-mailit zyrtar në adresën elektronike:
shitja@pak-ks.org
- o Vizitoni faqen zyrtare: www.pak-ks.org
- o Rregjistroni informatat tuaja në shitja@pak-ks.org në mënyrë që të njoftoheni me shpalljet e shitjeve të ardhshme.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



PRIVATIZIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PRIVATIZIMI NË KOSOVË

Nga rreth 600 ndërmarrje shoqërore (NSh) sa figurojnë të jenë në pronësi shoqërore, Agjencia deri më tani ka arritur të privatizoj shumicën dërmuese të tyre, duke krijuar nga ndërmarrjet shoqërore një apo më shumë ndërmarrje të reja private, përmes dy metodave kryesore: metoda e Spin-Off-it dhe metoda e Likuidimit apo shitjes së aseteve. Deri më tani janë mbajtur 59 valë të Privatizimit dhe 23 shitje të aseteve të NSh-ve në likuidim, janë përfshirë në privatizim 406 NSh, prej të cilave janë krijuar dhe tenderuar 834 ndërmarrje të reja. Nga këto privatizime deri më tani janë grumbulluar në fondet e mirëbesimit rreth 600 milionë euro.

Investimet nga vendi dhe jashtë

Përmes investimeve private në procesin e privatizimit, sot Kosova dhe ekonomia e saj ka të krijuara një numër të madh të ndërmarrjeve private nga ato shoqërore të cilat janë storie suksesi në vend dhe jashtë. Përpos rritjes së vlerës së këtyre ndërmarrjeve dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës, disa nga këto ndërmarrje konkurrojnë me ato të shteteve të zhvilluara.

miniera dhe minerale

industri

agrokulturë

ndërtimtari

tekstil

turimzëm dhe hotelieri

Punëtorët

Punëtorët janë përfitues të drejtpërdrejt nga shitja e ndërmarrjeve dhe vazhdojnë të marrin pjesën e 20 % nga çmimi i shitjes. Deri më tani numri i punëtorëve përfitues është mbi 38 mijë punëtorë ndërsa shuma e shpërndarë është rreth 80 milionë euro.

Pasurimi i buxhetit të shtetit

Që nga bartja për herë të parë të rreth 30 milionë euro mjete të mbetura nga procesi i likuidimit të 65 NSh-ve në buxhetin e Republikës së Kosovës, që ka ndodhur në vitin 2012, shpërndarja e fondeve për kreditorët e ndërmarrjeve shoqërore dhe teprica për buxhetin e Kosovës mbetet synim primar për Agjencinë.

Transparenca

Agjencia gjatë gjithë kohës po dëshmon transparencë të plotë gjatë organizimit të tenderëve, duke transmetuar përmes internetit ceremonitë e dorëzimit dhe hapjes së ofertave edhe përmes kamerave për të mundësuar të ndiqen ceremonitë nga të gjithë të interesuarit, pa marrë parasysh se ku gjenden ata.

Privatizimi si metodë përmbyllet me shpalljen e valës 60 që do të ndodh gjatë vitit 2014, ndërsa mbetet të vazhdohet me shitjen e aseteve të N.Sh.-ve në likuidim sipas metodave të reja inovative të shitjeve.